

## Deklaratë politike

Për mua është nder, por edhe përgjegjësi të kandidoj për kryetar të qytetit tim të dashur, ku jam lindur, rritur dhe edukuar në frymë civilizuese.

Unë kam vendosur të kandidoj si i pavarur dhe kështu do të mbetem. Ju lutem të më shikoni dhe besoni si një kryetar, jo-partiak, transparent dhe autentik.

Për mua është e rëndësishme, të jem kryetar i barabart për të gjithë qytetarët pavarësisht gjinisë, moshës, etnisë, religjionit, qëndrimit partiak, pasurisë së fituar me biznes apo rrogë.

Me një qytetari aktive, asamble shumë të angazhuar, qeveri lokale profesionale dhe një kryetar me vizion të sinqert, për katër vitet e ardhëshme do ta nxjerrim qytetin nga letargjia e së kaluarës dhe do të realizojmë një Mitrovicë të re, të ri-industrializuar, të zhvilluar ekonomikisht, të barabart politikisht, një qytet me kulturë dhe traditë, një qytet sportiv dhe shumë modern.

Basri Brahim, kandidat i pavarur

